



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Kryesia e Kuvendit

P-013

Prishtinë, më 8 prill 2008, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

**I Mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit me Kryetarët e Grupeve
Parlamentare, të Mbajtur më 8 Prill 2008**

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Naim Maloku, Slllobodan Petroviq, Eqrem Kryeziu dhe Xhezair Murati.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Lulzim Zeneli, Ardian Gjini, Bojan Stojanoviç, Ibrahim Makolli dhe Zylfi Merxha.

Kryetari i Kosovës, Fatmir Sejdiu;

Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi;

Zëvendëskryeministri, Hajredin Kuçi ;

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Thëllënza Arifi dhe Sherif Konjufca ;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi;

Nga Zyra Amerikane në Prishtinë : AJ. Rei- Perrine dhe Bajram Gecaj;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI: Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me Mocionin përmbajtjesor që Kryeministri i Kosovës, së bashku me Presidentin e Kosovës, ia kishin adresuar Kuvendit, me të cilin propozohet të thirrej Seanca e jashtëzakonshme solemne e Kuvendit të Kosovës për të shqyrtuar një pikë të rendit të ditës, si vijon:

1. Miratimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Kryetari ftoi Kryetarin e Kosovës ta marrë fjalën.

Kryetari i Kosovës, **Fatmir Sejdiu**, tha se tani jemi në një proces të përbashkët të përmbylljes më të mirë të mundshme të korpusit legjislativ, në kuptimin e nxjerrjes së aktit më të lartë të Republikës së Kosovës – Kushtetutës së Kosovës. Dje ka përfunduar dorëzimi solemn i Projektit të Kushtetutës nga ana e Komisionit Kushtetues të Republikës së Kosovës. Ky Komision gjatë procesit ka pasur bashkëpunim të mirë me të gjithë mekanizmat e tjerë institucional, por edhe me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë. Projekti i Kushtetutës është një dokument i qëndrueshëm që siguron një funksionim dhe saktësim normal të institucioneve dhe të fushëveprimtarive të institucioneve të Kosovës, por edhe funksionimin e gjithë sistemit shtetëror. Sipas procedurave Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë, z. Peter Feith e ka bërë certifikimin e këtij dokumenti, duke parë dhe hetuar përputhshmërinë e tij të plotë edhe me standardet ndërkombëtare dhe Projektin e Ahtisarit.

Ai shtoi se, së bashkë me Kryeministrin, ia kanë proceduar një kërkesë të përbashkët Kuvendit, që miratimi i Projektit të Kushtetutës të procedohet në një seancë të jashtëzakonshme me karakter solemn, sa më shpejtë, sepse është në interes të Kosovës të përmbyllë këtë periudhë të tranzicionit.

Në fund, Kryetari i Kosovës ia dorëzoi solemnisht tekstin e Projekt Kushtetutës Kryetarit të Kuvendit.

Kryeministri, **Hashim Thaçi**, tha se besoj që, ashtu siç kemi punuar bashkërisht dhe me seriozitetin më të lartë për shpalljen e Kosovës shtet të pavarur, sovran dhe demokratik, tash do të ecim me hapa të tjerë, shumë të rëndësishëm për legjitimitimin e shtetit tonë me nxjerrjen e Kushtetutës moderne, të vullnetit të qytetarëve të Kosovës, e cila sublimon të kaluarën, të sotmen dhe të ardhmen e vendit tonë si shtet i pavarur dhe sovran, vend i të gjithë qytetarëve të Kosovës. Qeveria e Kosovës premton që pas aprovimit të Kushtetutës së Kosovës, do të punojë për të respektuar me përpikëri Kushtetutën e shtetit të Kosovës dhe uroj që nesër, në seancën e jashtëzakonshme, të jetë një seancë përsëri e përgjegjësive të larta dhe e unitetit tonë të plotë shtetformues dhe gjithëqytetarë.

Kryetari hapi debatin lidhur me propozimin e Kryeministrit dhe të Presidentit.

Nexhat Daci tha se kërkesa e parashtruar nga ana e Kryeministrit dhe Presidenti të Kosovës është shumë e arsyeshme, të cilën duhet mbështetur.

Kosovën si shtet sovran dhe të pavarur e kanë njohur shtetet, më demokratike dhe të zhvilluara të botës, që përbëjnë më shumë se 60% të GDP-së botërore.

LDD e përkrah propozimin dhe vlerëson lartë punën e Komisionit Kushtetues, në veçanti të kryetarit të Komisionit për përfshirje të spektrit të gjërë në Komision.

Sabri Hamiti e mbështeti kërkesën e kryeministrit dhe të Presidentit për procedimin e Projekt-Kushtetutës, të cilën e vlerësoi - Kushtetuta e shtetformimit.

Ne jemi në fazën kur do ta përmbyllim shtetformimin e Kosovës në kuptimin politik dhe në kuptimin legjislativ dhe mendoj se në kuadrin e gjithë këtyre rrethanave dhe lëvizjeve dinamike politike brenda dhe jashtë – aprovimi i kësaj Kushtetute s’duhet të jetë diçka tjetër pos një solemnitet i të gjithë neve që përfaqësojmë vullnetin e qytetarëve të Kosovës.

Naim Maloku, në emër të AAK-së, përgëzoi Komisionin Kushtetues për punën që e ka bërë. Ne e përkrahim fuqimisht miratimin e kësaj Kushtetute dhe përkrah propozimin që të jetë një seancë solemne dhe në kohën sa më të shpejtë të mundshme të thirret Kuvendi për ta miratuar Kushtetutën.

Ibrahim Gashi përgëzoi Komisionin Kushtetues për punën që ka bërë, shumë përkushtuese, impenjuese dhe frytdhënëse gjatë hartimit të Kushtetutës.

Edhe Aleanca Kosova e Re është përfshirë dhe ka dhënë kontributin e saj në fazën intensive të hartimit të projekt-Kushtetutës.

Ai mbështeti propozimin që Kushtetuta të miratohet në seancën e nesërme në Kuvend.

Xhezair Murati në emër të Grupit Parlamentar “7+”, të cilin e përbëjnë tri komunitete, falënderoi Komisionin Kushtetues për punën e bërë me kompetencë dhe në mënyrë demokratike, në të cilën janë përfshirë edhe përfaqësuesit e komuniteteve.

Deputetët e Grupit Parlamentar “7+”, shtoi ai, do ta mbështesin miratimin e Kushtetues në seancën e nesërme.

Kryesia, pas këtyre diskutimeve, vendosi që seanca e jashtëzakonshme solemne të mbahet më 9 prill 2008, në orën 10:00.

Në vazhdim, Kryesia vazhdoi punimet vetëm me anëtarët e saj dhe me kryetarët e grupeve parlamentare.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë mbajtur më 1 prill 2008,
2. Propozimi i rendi i ditës për seancën e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i Informatës së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Miniera, Transport e Telekomunikacion lidhur me nismën për hartimin e Projektligjit për shfrytëzimin e ujërave, ujërave të zeza dhe të mbeturinave,
4. Shqyrtimi i kërkesës së PSHDK – së lidhur me ndarjen e mjeteve të alokuara për partitë politike, të përfaqësuara në Kuvend,
5. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Bahri Hyseni për lejimin e udhëtimit zyrtar në Strasburg,
6. Të ndryshme:
 - 6.1 Shqyrtimi i Propozimvendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 20 për shpenzimet telefonike, dhe
 - 6.2 Njoftimi i OSBE-së lidhur me trajnimet, seminarët dhe vizitat parlamentare për periudhën mars- maj 2008.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë të mbajtur më 1 prill 2008

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur më 1 prill 2008, u miratuan pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare

Kryetari informoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me materialet e përgatitura për seancën e radhës. Ai kërkoi pëlqimin e tyre për secilën pikë të rendit të ditës, veç e veç.

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca e radhës të mbahet më 17 prill 2008, në orën 10:00, me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë Projektligjit për sponsorizimet në kulturë, rini dhe sporte,
4. Shqyrtimi parë i Projektligjit për Ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet e tjera,
5. Shqyrtimi parë i Projektligjit për ndërmjetësim.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet pa praninë e kryetarëve të grupeve parlamentare.

3. Shqyrtimi i Informatës së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Miniera, Transport e Telekomunikacion (ETIEMTT) lidhur me nismën për hartimin e Projektligjit për shfrytëzimin e ujërave, të ujërave të zeza dhe të mbeturinave,

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë me Informatën e Komisioni Parlamentar ETIEMTT, të cilën e kishte përgatitur në bazë të përfundimit të Kryesisë të datës 25 mars 2008.

Kryesia, pas diskutimit të të gjithë anëtarëve të saj lidhur me informatën e Komisionit, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet nisma e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Miniera, Transport e Telekomunikacion për hartimin e Projektligjit për shfrytëzimin e ujërave, ujërave të zeza dhe të mbeturinave.
2. Komisioni, sipas paragrafit 1 i këtij vendimi, obligohet që punët për hartimin e Projektligjit ta kryej për jo më shumë se tri takime.
3. Kërkohet nga Komisioni që gjatë takimeve të punës për hartimin e Projektligjit nga paragrafi 1 i këtij vendimi, t'i konsultoj edhe hartuesit e draftit të parë.
4. Kompensimi për pjesëmarrjen e anëtarëve të nënkomisionit për hartimin e këtij Projektligji, bëhet në shumën prej 30€, për çdo takim pune.

4. Shqyrtimi i kërkesës së PSHDK – së lidhur me ndarjen e mjeteve të alokuara për partitë politike, të përfaqësuara në Kuvend

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë se përfaqësuesit e PSHDK-së kanë kërkuar ndarjen e mjeteve të alokuara për partitë politike nga Grupi Parlamentar i LDD-së.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e PSHDK-së, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Partisë Shqiptare Demokristiane të Kosovës për ndarjen e mjeteve për partitë politike të përfaqësuara në Kuvend, sipas numrit të deputetëve.
2. Obligohet Sekretari i Kuvendit që mjetet nga paragrafi 1. i këtij Vendimi t'ia alokojë Partisë Shqiptare Demokristiane të Kosovës.

5. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Bahri Hyseni për lejimin e udhëtimit zyrtar në Strasburg

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e deputetit Bahri Hyseni, mori këtë

V E N D I M

1. Deputetit Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, i lejohet udhëtimi zyrtar në Strasburg, prej datës 25 deri më 28 mars 2008.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit të deputetit, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, i bartë organizatori.
3. Shpenzimet shtesë të mëditjeve sipas Vendimit Nr: 02-2242-1/06 i bartë buxheti i Kuvendit.

6. Të ndryshme:

6.1 Shqyrtimi i Propozimvendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 20 për shpenzimet telefonike

Kryesia pasi e diskutoi propozimvendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr.20, të njëjtin e miratoi.

6.2 Njoftimi i OSBE-së lidhur me trajnimet, seminarët dhe vizitat parlamentare për periudhën mars- maj 2008

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë me shkresën e OSBE-së, me të cilën informohej Kuvendi lidhur me trajnimet, seminarët dhe vizitat parlamentare për periudhën mars-maj 2008, të organizuara nga Iniciativa për Mbështetje Kuvendit ASI, Projekti i financuar nga AER-i, Instituti Nacional Demokratik NDI, dhe Qendra Kombëtare për gjykatat shtetërore dhe Misioni i OSBE-së.

Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 12:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

E hartoi:
Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale